



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1963/Prot.
2

Tiranë më 10.5.2019

VENDIM

Nr. 20, datë 06.05.2019

“Për miratimin e ndryshimeve deri në masën 20%, të programit mësimor të studimit Master profesional në “Orientim Profesional”, të Fakultetit të Shkencave Sociale UT, për vitin akademik 2019-2020”

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, pika 2, gërma “b”; neni 25, pika 1; neni 35, pika 4 dhe pika 9; neni 38, pika 1; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 14, pika 5; gërma “a”; neni 31; si dhe në propozimin e përcjellë nga Fakulteti i Shkencave Sociale, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 06.05.2019;

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Shkencave Sociale për ndryshime deri në masën 20%, në programin mësimor të studimit “Master profesional” në “Orientim Profesional”, për vitin akademik 2019-2020.
2. Ky vendim i përcillet për njoftim Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

